



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 13.6.2024, merr këtë

V E N D I M  
P Ë R  
R R I T J E N D H E B A R T J E N E M J E T E V E N G A T E J K A L I M I I P L A N I T P Ë R T Ë H Y R A  
V E T J A K E N G A V I T I 2 0 2 3 N Ë V I T I N 2 0 2 4

- MIRATOHET** Vendimi për rritjen dhe bartjen e mjeteve nga tejkalimi i planit të të hyrave vetjake nga viti 2023 në vitin 2024.
- Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, bëhet rritja dhe bartja e tejkalimit të planit të të hyrave vetjake nga vitit 2023 në vitin 2024, në vlerë prej **3,339,999.30€**.
- Mjetet nga tejkalimi i të hyrave vetjake nga viti 2023, do të destinohen në kategoritë për:

3.1. <i>paga dhe shtesa – 110</i> .....	150,000.00 €;
3.2. <i>mallra dhe shërbime – 130</i> .....	1,423,130.85 €;
3.3. <i>investime kapitale – 300</i> .....	1,766,868.45 €;

**Gjithsej: 3,339,999.30 €;**
- Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa tabelore.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-400/03-77937/24, më 18.6.2024

KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kupina



## Arsyetim

Mbështetur në Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësive dhe Ligjin mbi buxhetin, nr. 08/L-260, neni 9, pika 7, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për bartjen e mjeteve si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Tejkalimi i planit për të hyra vetjake përfshinë vlerën e mbledhur mbi planin buxhetor për vitin 2023, në vlerë prej 552,803.67 €, si dhe mjetet nga gjobat e trafikut, gjobat e gjykatave dhe gjobat për pyje për vitin 2023, në vlerë prej 2,787,195.63 €, gjithsej mjetet për tejkalim të të hyrave vetjake për vitin 2023 janë 3,339.999.30 €. Sipas kategorive do të jetë:

- Kategoria e pagave dhe shtesave, kompensimin e mësimit joformal për shkollat profesionale për vitet 2022 -2024, obligime të papaguara, në vlerë prej 150,000.00 €, gjithsej kategoria e pagave dhe shtesave 150,000.00 €;
- Kategoria e mallrave dhe e shërbimeve, janë obligime ndaj kontratave të hapura, obligime ndaj lëndëve të cilat janë në OSHP, janë për konkurse ndërkombëtare për projekte ideore/zbatuese, për bashkëfinancime me partnerët e jashtëm për projekte, obligime në vlerë prej 1,423,130.85 €;
- Kategoria e investimeve kapitale, janë obligime të mbetura ndaj kontratave të hapura, obligime ndaj lëndëve të cilat janë në OSHP, si dhe projekteve të cilat janë në procedura, obligime në vlerë prej 1,766,868.45 €.

Të bashkëngjitura janë në forma tabelore.